

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6589
E enjte, 21 prill 2022
çmimi 0.40 €

Goditet grupi kriminal i cili bashkëvepronte në Shqipëri dhe Kosovë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA BOJKOTON KOMISIONET PARLAMENTARE



Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), janë duke bojkotuar punën e Kuvendit të Kosovës. Të mërkurën përfaqësuesit e këtyre partive kanë bojkotuar mbledhjet e komisioneve parlamentare, duke theksuar se nuk do të votojnë asnjë projektligj përderisa nuk formohet komisioni hetimor parlamentar për energjinë. Si pasojë e bojkotit, ka dështuar të mërkurën raportimi i ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në Komisionin për Integrim Evropian. Po ashtu, ka dështuar edhe mbledhja e Komisionit për Legjislacion

Shkruan:
Kudusi LAMA



Parlamenti Evropian përsërit thirrjen për liberalizim të vizave për Kosovën



"FREEDOM HOUSE" PËR KOSOVËN: INSTITUCIONET MBESIN TË DOBËTA, KORRUPSIONI I SHFRENUAR

FAQE 7

LAJÇAKU NË BEOGRAD: PRESIM QË TË ZBATOHEN TË GJITHA MARRËVESHJET E DIALOGUT

REÇICA: PO I RIKTHEJMË BASHKATDHETARËT NË PDK

EKONOMI



KOSOVA DHE SHQIPËRIA JANË DUKE FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË BUJQËSI

BSPK-ja I OFRON MUNDËSI QEVERISË PËR DIALOG

SPORT

GJINOVCI: SYNOJMË KUALIFIKIMIN NË EVROPIAN

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Mbi 5 milionë persona janë larguar nga Ukraina

GJENEVË, 20 PRILL - Agjencia për refugjatë e Kombeve të Bashkuar tha se numri i ukrainasve që janë larguar nga shteti i tyre, qëkur Rusia nisi pushtimin e paprovokuar, ka kaluar shifrën 5 milionë. Kjo konsiderohet kriza më e madhe e refugjatëve në

Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Sipas të dhënave të publikuara më 20 prill nga agjencia për refugjatë e OKB-së, UNHCR, 5 034 439 ukrainas janë larguar nga vendi që prej nisjes së luftës më 24 shkurt. OKB-ja tha se 90 për

qind e atyre që janë larguar janë gra dhe fëmijë, pasi autoritetet në Kiev nuk lejojnë burrat e moshës së ushtrisë që të largohen nga shteti. Më 5 prill OKB-ja kishte thënë se afër 7.1 milionë persona ishin zhvendosur brenda Ukrainës për shkak të luftës.



Lajçaku në Beograd: Presim që të zbatohen të gjitha marrëveshjet e dialogut

BEOGRAD, 20 PRILL - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në një takim me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, më 20 prill, tha se shtetet e bllokut presin që të dyja palët t'i zbatojnë të gjitha gjërat për të cilat janë marrë vesh gjatë dialogut të zhvilluar në dhjetë vjetët e fundit.

Sipas një njoftimi të publikuar nga Presidenca serbe, Lajçak tha se do të vazhdojë të angazhohet për vazhdimin e dialogut nën ndërmjetësimin e BE-së, pa vonesa të mëtejme.

Ndërkaq, në një postim në "Twitter", Lajçak tha se ka biseduar me Vuçiçin për të gjitha çështjet që aktualisht janë në agjendë, përfshirë edhe për takimin e ri të nivelit të lartë.

Vuçiçi dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, si bartës së dialogut, për herë të fundit janë



takuar në korrik të vitit 2021.

Ndërkaq, në njoftimin e Presidencës serbe thuhet se Vuçiçi gjatë takimit tha se kanë kaluar nëntë vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe "ende nuk ka përparim në zbatimin e

obligimeve të Prishtinës, para së gjithash për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Serbia pret që marrëveshjet e arritura të respektohen dhe zbatohen plotësisht".

Takimi Vuçiçi - Lajçak u mbajt në

një ditë para se të skadojë afati kur Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje për çështjen e targave të makinave. Marrëveshja e përkohshme për targat, sipas së cilës, simbolet shtetërore të Kosovës dhe Serbisë në targa mbulohen me letër ngjitëse, u arrit më 30 shtator të vitit të kaluar, që kishte për qëllim t'i ulte tensionet në veri të Kosovës. Më pas u formuan grupet punuese, të cilat deri më 21 prill duhet të paraqesin një zgjidhje të përhershme për targat "bazuar në standardet dhe praktikatat e BE-së".

Në BE kanë konfirmuar se më 21 prill në takim do të marrin pjesë kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi dhe ai i Serbisë, Petar Petković. Takimi ka për qëllim analizimin e propozimeve të grupeve punuese dhe nëse palët merren

vesh, të arrijnë një zgjidhje të pranueshme për Kosovën dhe Serbinë.

Kosova kishte vendosur reciprocitetin për targat serbe më 20 shtator, masë e cila nënkuptonte që makinat me targa të Serbisë t'i zëvendësonin ato me targa provuese, të vlefshme për 60 ditë dhe që kushtonin pesë euro. Me masë të ngjashme makinat nga Kosova ishin përballur për një dekadë.

Më 18 prill kryeministri Kurti tha se për Kosovën parimi i reciprocitetit për zgjidhjen për targat është i padiskutueshëm dhe i panegociueshëm. Por, nga Zyra për Kosovën në qeverinë serbe kanë thënë se fjala "reciprocitet" nuk përmendet askund në marrëveshjen e përkohshme. Ndërkaq, Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje palëve që të arrijnë kompromis për çështjen e targave.

Abazović: Kemi rënë dakord për qeverinë e re

PODGORICË, 20 PRILL - Mandatari për formimin e Qeverisë së re të Malit të Zi, Dritan Abazović, njëherësh udhëheqës i Lëvizjes Qytetare URA, njoftoi të mërkurën se është rënë dakord për përbërjen e qeverisë së re.

Mosbesimi ndaj qeverisë së mëparshme të Malit të Zi, të udhëhequr nga kryeministri Zdravko Krivokapiq, është votuar më 4 shkurt. Duke folur në një konferencë për medie në Podgoricë, Abazović tha se e ka njoftuar Kuvendin e Malit të Zi për marrëveshjen e arritur për zgjedhjen e qeverisë së re. Ai tha se kabineti i tij do ta ketë mbështetjen e 46 deputetëve nga 81 sa ka gjithsej Kuvendi i Malit të Zi. "Ideja është që ta zhbllokojmë Malin e Zi, që shteti të ketë institucione funksionale dhe stabilitet. Në vend që të grindemi, të kemi pajtim dhe të përpiqemi të ndërtojmë një perspektivë evropiane. Ne nuk jemi kundër zgjedhjeve, por jemi kundër zgjedhjeve pa institucione", tha Abazović.

Ai nuk dha shumë detaje për përbërjen e kabinetit, por tha se nëse merr mbështetje në Kuvend, ai do të ketë 20 ministra dhe katër nënkryetarë.

Abazović tha se beson se seanca e Kuvendit, në të cilën do të zgjidhet qeveria e re, do të mbahet javën e ardhshme.

Qeveria e re pritet të përbëhet nga Lëvizja Qytetare URA e Abazovićit, Partia Popullore Socialiste, e cila është pro-serbe, Partia Socialdemokrate dhe partitë kombëtare të shqiptarëve dhe boshnjakëve.

Qeveria pritet ta ketë mbështetjen parlamentare edhe nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e presidentit malazez Milo Gjukanović.

Ky i fundit ka konfirmuar më 19 prill se DPS-ja do ta mbështesë qeverinë e pakicës "pa asnjë interes apo pjesëmarrje në të".

Duke folur për prioritetet e kabinetit të tij, Abazović tha se në fokus do të jenë: dialogu, reformat në drejtësi, shqyrtimi i vendimeve të diskutueshme të qeverisë së mëparshme dhe vazhdimi i reformave të shërbimeve të sigurisë. "Ndër prioritetet normative janë marrëveshja për bartësit e funksioneve gjyqësore, harmonizimi i rregulloreve gjyqësore me rregulloret e BE-së, Ligji për Originën e Pronës i cili pret dritën jeshile të BE-së,



reforma zgjedhore, rishikimi i gjendjes aktuale në arsim dhe kulturë, si dhe rishikimi i të gjitha vendimeve për personelin në këto fusha", tha Abazović. Ai shtoi se prioritetet e tij do të jenë edhe Ligji për regjistrimin, rregullimi i marrëdhënieve me komunitetet fetare dhe shqyrtimi i iniciativave rajonale, me qëllim të anëtarësimit sa më të shpejtë në BE.

Abazović është propozuar për kryeministër të Qeverisë së re të

Malit të Zi më 3 mars nga presidenti i këtij vendi, Milo Gjukanović.

Paraprakisht, mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë së deriatëhershme ka kaluar në Kuvend me votat e URA-s së Abazovićit dhe të opozitës së udhëhequr nga DPS-ja e Gjukanovićit. Qeveria e Krivokapiqit është formuar në dhjetor të vitit 2020 nga një koalicion mes Frontit Demokratik pro-serb dhe pro-

rus, Demokratëve dhe Lëvizjes Qytetare URA.

Kjo qeveri ka pasur një shumicë të ngushtë në Kuvend - prej 41 deputetësh - por e ka kthyer DPS-në në opozitë pas tri dekadash.

Dallimet në qëndrime midis partnerëve të koalicionit kanë nisur të shpërfaqen shumë shpejt pas formimit të tij dhe palët shpesh nuk kanë qenë të njëzëshme në vendime. Pak ditë pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, kryetari i Kuvendit të Malit të Zi, Aleksa Beçiq, udhëheqës i Demokratëve, është shkarkuar, po ashtu.

Fronti Demokratik pro-serb dhe pro-rus dhe Demokratët kundërshtojnë zgjedhjen e qeverisë së pakicës dhe kryesuesi i parlamentit malazez nga Fronti Demokratik, Strahinja Bullajiç, dha dorëheqje të mërkurën për shkak të kësaj. Këto grupe politike konsiderojnë se zgjedhja e qeverisë së re dhe formimi i shumicës së re parlamentare paraqesin shkelje të Kushtetutës dhe të vullnetit zgjedhor të qytetarëve. Fronti Demokratik dhe Demokratët kanë paralajmëruar më herët protesta.

“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” apo luftë çlirimtare e Kosovës? (2)

Gjykata Speciale, një ‘Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale’ kundërshtiptare?



Shkruan: Kudusi LAMA

Prej këtej unë kuptoj se jemi përballë një Ndërmarrjeje të Përbashkët Kriminale kundërshtiptare nën dirigjimin e Këshillit të Europës për ta kënaqur Serbinë. Jemi përballë një Ndërmarrjeje të Përbashkët Kriminale kundërshtiptare sepse duhet të kënaqen interesat e armiqve të shqiptarëve me të cilët jemi ndeshur historikisht për të mbrojtur trojet tona. A ka mundësi që Europa të jetë kaq kundërshtiptare? Si ka mundësi që Europa të jetë kaq e padrejtë me shqiptarët duke u thirrur në drejtësinë? A deri në këtë shkallë Europa moderne duhet të shpërfaqë arrogancën e saj për interesat e të dashurve të saj, pavarësisht sa kriminelë janë? A deri këtu duhet të shkojë Europa, sa edhe luftën e shqiptarëve për liri, të tentojë ta kthejë në një “ndërmarrje të përbashkët kriminale?” Cila është qytetaria e shtetarëve evropianë, sepse jam i sigurt se po të pyeteshin qytetarët evropianë, do t’i brohorisin lirisë e jo padrejtësisë. Ta emërtosh një ushtri që bën luftë çlirimtare, Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale, është krimi më i madh që mund të bëhet ndaj një populli e një kombi.

Mirëpo a e di Europa se lufta çlirimtare e Kosovës është kryer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila është drejtuar dhe udhëhequr nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe se

nëpërmjet atij shtabi ka funksionuar një udhëheqje kolegjiale dhe se që nga plani strategjik politiko – ushtarak i luftës, në asnjë direktivë, në asnjë urdhër, në asnjë udhëzim, në asnjë komunikatë, në asnjë thirrje dhe në asnjë tubim, nuk ka një rast të vetëm, që ky shtab të ketë ndërmarrë hapa kriminalë, të ketë bërë veprime kriminale, të ketë krijuar situata që njësitë e repartet të jenë kriminalizuar.

Në këto kushte, ku i lind e drejta kësaj gjykate e cila është krijuar mbi themele kriminale, të krijojë një ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe të na thotë: “tani sipas asaj që dua unë ju shqiptarët jeni pronarët e kësaj ndërmarrjeje sepse kështu dua unë?” Kjo gjykatë që vetë i ka themelet mbi krim, sepse është krijuar për të kënaqur shpifjet serbe, sipas një raporti kriminal, të argumentuar katërçipërisht kriminal, sipas një vendimi emocional të Këshillit të Europës, që ka ardhur si rrjedhojë e shpifjeve të raportit të Dick Marty-t, që është raporti i Serbisë, por që i paguari i saj Marty hodhi firmën mbi të.

Nisur nga sa më sipër, si ka mundësi që kjo prokurori special bëri përzgjedhje selektive dhe mori në burg katër prej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Po sikur president, kryetar parlamenti, kryetar partie kryesore, apo kryetar grupi parlamentar në

parlamentin e Kosovës të ishin katër të tjerë, jo Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, si do ta kishin emrin të burgosurit e kësaj prokurorie dhe cilët do t’i kishte në bankën e të akuzuarit sot ajo gjykatë? Jam i sigurt se jo këta të katër, por katër emra të tjerë që do të gjendeshin në ato funksione.

Për fatin tuaj të keq, jeni bërë me turp, si Parlamenti e Europës ashtu edhe kjo gjykatë e pandëruar. Me turp, sepse po veproni akoma me mendësitë e shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, kur shqiptarët dhe trojet e tyre konsideroheshin vetëm si kurban, për interesat europiane, për të kënaqur shijet sllave dhe greke nëpërmjet bërjes kurban të shqiptarëve e trojeve të tyre. Kjo duket sot kur për të kënaqur serbët marrin si të pandehur udhëheqësit e shqiptarëve, vetëm pse ata janë të përkushtuar për të bërë të fuqishëm kombin shqiptar. Sepse ata kanë luftuar dhe punojnë me shumë forcë, për të mos e lënë Serbinë të ketë më tej fuqi mbi trojet shqiptare.

Por ja që aktakuzat e ngritura në Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë, ndaj ish-kreerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, i ngarkojnë ata me barrën e organizimit dhe drejtimit të një “ndërmarrjeje të përbashkët

kriminale”. U gjet pra një term për të fyer dhe akuzuar shqiptarët, për të fyer dhe akuzuar luftëtarët, për të fyer dhe akuzuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për të fyer dhe nxjerrë jashtë parametrevë të së drejtës luftën çlirimtare të Kosovës. Shqiptarët luftëtarë pra, nuk paskan qenë tjetër veçse pjesëtarë të një “organizate kriminale”, dhe kjo sepse kanë luftuar për çlirim, dhe këtë etiketë fyese dhe akuzuese e vendos Europa. Ajo Europë që dje ishte bashkëluftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ajo Europë që dje i kishte burrat e saj në luftë si pjesë përbërëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo Europë që i pa me sy vetë krimet serbe mbi qytetarët shqiptarë të pa armatosur në Kosovë. Pas 20 vjetësh pra ajo Europë u bë pishman, për luftën që ka bërë për çlirimin e Kosovës. A mos do të arrijë deri atje sa t’i kërkojë falje Millosheviqit për veprën e saj çlirimtare?

Në luftë gjithsecili është përgjegjës për veprimin që kryen

Sipas vlerësimeve të kësaj gjykate speciale të pandëruar, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk paska bërë luftë çlirimtare, por qenka marrë veç me organizime e kryerje krimesh, pasi vetë termi “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” - nënkupton që të gjithë pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk janë tjetër veç pjesëtarë të kësaj ndërmarrje, sepse këta luftëtarë (Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi), nuk akuzohen në asnjë nga pikat e aktakuzës se kanë kryer krime me dorën e tyre, por se kanë organizuar kriminalitetin, si drejtuese e udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që kanë qenë, (megjithëse kam thënë më lartë, që këta janë përzgjedhur veçse ishin funksionar të shtetit të lirë të Kosovës, pasi udhëheqës të luftës ka pasur edhe të tjerë e edhe me funksione më të larta se të tyre. Prandaj kam shtruar pyetjen më lartë, se nëse do të ishin të tjerë në funksionet që qenë të akuzuarit - si do ta kishin emrin të akuzuarit në Hagë sot?) në atë periudhë për të cilën akuzohen. Pra, ata ishin një grup, që sipas kësaj prokurorie politike e quajtur

speciale, nuk kanë bërë punë tjetër, por veç kanë punuar në grup me dijeni të plotë e me ndërgjegje të qetë, për të planifikuar e kryer krime. Edhe në luftë, gjithsecili është përgjegjës për veprimin që kryen. Në luftë ushtari është mbret, ai ka armë, ka pozicionin, ka municionin, ka armikun përballë dhe e shkreh armën kur e vlerëson se e ka vënë mirë armikun në shënjestër, por në asnjë mënyrë nuk e shkreh armën pa objektiv veçse ka marrë urdhër të bëjë një gjë të tillë. Kështu, të mendosh se për veprimet e ushtarit duhet marrë nën përgjegjësi dikush tjetër, kjo nuk ha arsyë.

Veprim i pabazuar dhe absurd

Ishte një kohë kur gjithë faktorët ndërkombëtarë e kanë njohur, vlerësuar, miratuar dhe përkrahur si të drejtë dhe të patjetërsueshme veprën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si një vepër humane, që ka marrë përgjegjësinë t’ia japë lirinë atdheut dhe kombit të shqiptarëve të pushtuar e të kolonizuar.

Por sot po jepet një emërtesë ndryshe. Dhe jepet nga një institucion e strukturë që quhet e Kosovës, siç është kjo gjykatë e pandëruar speciale në Hagë, që kërkon të veshë ushtrinë çlirimtare me uniformën e kriminalitetit.

Mirëpo, ku janë direktivat që Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka lëshuar që ushtria të cilën e ka pasur nën udhëheqje të bëjë krime? Ku janë urdhrat, udhëzimet, rregulloret, deklarimet etj.? Nëse do të kishte dokumente të tilla, edhe unë do të isha dakord, që këta burra të akuzohen dhe të gjykojnë se kanë qenë anëtarë dhe funksionarë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ashtu sikurse do të kërkoja që të merren të pandehur edhe anëtarët e funksionarët e tjerë të atij shtabi. Por kur nuk ka asnjë dokument të tillë, ku qëndron e drejta që këta burra të merren të pandehur? Apo kjo është thjeshtë e drejta e të fortit; e drejta e atij që abuzon me forcën që ka për interesat e veta; e drejta e atij që e rrotullon fjalën dhe ligjin vetëm në interes të vetes a të të dashurve të vet. Ky veprim është sa i pabazuar në të drejtën ligjore, aq edhe absurd. (Vijon)



Opozita bojkoton komisionet parlamentare

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), janë duke bojkotuar punën e Kuvendit të Kosovës. Të mërkurën përfaqësuesit e këtyre partive kanë bojkotuar mbledhjet e komisioneve parlamentare, duke theksuar se nuk do të votojnë asnjë projektligj përderisa nuk formohet komisioni hetimor parlamentar për energjinë. Si pasojë e bojkotit, ka dështuar të mërkurën raportimi i ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në Komisionin për Integrim Evropian. Po ashtu, ka dështuar edhe mbledhja e Komisionit për Legjislacion

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 PRILL - Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), po bojkotojnë punën e Kuvendit të Kosovës.

Të mërkurën deputetët e këtyre partive opozitare kanë refuzuar të marrin pjesë në komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës.

Ky veprim i opozitës për bojkotim u bë pasi të martën, më 19 prill, në seancën e Kuvendit të Kosovës, nuk u arrit të futej në rend të ditës formimi i një komisioni hetimor parlamentar që do të kishte për qëllim hetimin e menaxhimit të krizës energjetike si dhe shkeljet eventuale gjatë punësimeve së fundi në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Komisioni hetimor është iniciuar

nga Partia Demokratike e Kosovës. Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu - Kodra, që është pjesë e Komisionit për Integrim Evropian, ka thënë se partia e saj nuk do të marrë pjesë në asnjë votim të projektligjeve përderisa nuk formohet komisioni hetimor. "Ne kemi pasur dy tentativa dhe keni parë që dje (19 prill) ka dështuar të miratohet një komision i tillë, i cili do të vendosë dritë mbi ato shumë parregullsi që kanë ndodhur në proces të shitjes së energjisë elektrike, por edhe shumë punësime që kanë ndodhur në KEK", ka thënë Deliu - Kodra.

Konfirmimin për mospjesëmarrje në punët e komisioneve të Kuvendit të Kosovës e kanë konfirmuar në këtë takim edhe deputetja e AAK-së, Time Kadriaj, si dhe Rrezarta Krasniqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Si pasojë e bojkotit, ka dështuar raportimi i ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Pas bojkotit nga

deputetët e partive opozitare, ka dështuar edhe mbajtja e Komisionit për Legjislacion.

Për refuzimin e formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar për krizën energjetike ka folur edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i cili ka thënë se ky refuzim hetimi është shenjë frike e pushtetit rreth të vërtetës që, megjithatë, do të zbardhet herët apo vonë. "Sa më i fortë refuzimi, aq më i domosdoshëm bëhet hetimi. Dhe sa më i domosdoshëm hetimi, aq më e drejtë bëhet kërkesa jonë për të. Sjella e mazhorancës, si tregues i arrogancës së numrave që parandalon ushtrimin e detyrimeve kushtetuese të Kuvendit mbi qeverinë, është praktikë kundërkushtetuese. E njëjta s'mund të vazhdojë", ka thënë ai.

Abdixhiku ka thënë se pa themelimin e këtij Komisioni Hetimor në Kuvend, pa gjetjen e së vërtetës rreth krizës energjetike në

Kosovë, asnjë nismë tjetër parlamentare nuk do të marrë mbështetjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Një ditë më parë kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se është hera e parë në historinë parlamentare të Republikës së Kosovës që pushteti i shumicës shkel të drejtën e pakontestueshme për hetim parlamentar, si një e drejtë kushtetuese për ta mbikëqyrur punën e qeverisë dhe institucioneve nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Kreu i opozitës ka thënë se bllokimi nga ana e shumicës parlamentare për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike është shkelje brutale e ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës nga mazhoranca dhe qeveria Kurti. "Kryeministri Kurti, përmes deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, për herë të dytë sot e bllokoi miratimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me krizën energjetike në vend, duke shkelur haptas ligjin dhe Kushtetutën, diçka që tashmë është bërë traditë dhe praktikë e kësaj qeverie. Por, përkundër këtij insistimi të këtij pushteti për ta mbajtur fshehtë krejt atë që ka ndodhur për muaj të tërë, sot ju

themi se arroganca e numrave të pushtetit nuk mund ta ndalojë nxjerrjen në dritë të së vërtetës", ka thënë Krasniqi.

Edhe kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka akuzuar qeverinë se ka penguar Kuvendin që të votojë për themelimin e komisionit hetimor që, sipas tij, ka për qëllim t'i hetojë shpenzimet dhe subvencionet për sektorin e energjisë. Ai ka thënë se grupi parlamentar i AAK-së nuk do të marrë pjesë në asnjë votim në Kuvend derisa të miratohet ky komision.

Partitë opozitare të martën, më 19 prill, e kanë lëshuar edhe seancën e Kuvendit të Kosovës pasi nuk është arritur formimi i komisionit hetimor për energjinë.

Deri në formimin e këtij komisioni opozita ka thënë se nuk do të votojë asnjë projektligj. Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari - Lila, ka thënë se Ligji për Hetimin Parlamentar nuk lejon formimin e komisionit hetimor për krizën energjetike. Ajo ka thënë se kryesuesi i komisionit duhet të zgjidhet nga partitë që nuk janë iniciuese të themelimit të komisionit. Për këtë ajo ka inkurajuar opozitën që të kërkojë interpretim në Gjykatën Kushtetuese.

Parlamenti Evropian përsërit thirrjen për liberalizim të vizave për Kosovën

PRISHTINË, 20 PRILL - Parlamenti Evropian ka përsëritur thirrjen për liberalizimin e vizave për Kosovën dhe për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në mënyrë që të dyja këto vende të avancojnë drejt Bashkimit Evropian. Këto thirrje janë përfshirë në tekstet e drafteve të raporteve për Kosovën dhe për Serbinë, të cilat i ka siguruar "Radio Evropa e Lirë".

Në raport përsëritet se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave që në vitin 2018, por ende nuk është miratuar vendimi për liberalizim vizash. Ndërkaq, i bëhet thirrje Këshillit të BE-së që urgjentisht ta marrë vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Në këtë raport thuhet se janë në dijeni për qëllimin e Kosovës për të aplikuar për anëtarësim në BE.

Kosova ka shënuar përparim në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe përshëndetet edhe përkushtimi për avancimin e reformave në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane, thuhet në këtë raport. Si dëshmi për këtë përmendet edhe fakti se Kosova ka avancuar për 17 pozita në indeksin e perceptimit të korrupsionit të organizatës Transparency International.

Gjithashtu, përmendet fakti se në Kosovë ekziston një mbështetje e madhe për integrim në BE gjatë vitit 2022. "Por, nënvizojmë faktin se nuk ekziston një procedurë e shpejtë dhe se normalizimi i raporteve me Serbinë është i domosdoshëm për avancimin e Kosovës në rrugën e saj evropiane", thuhet në tekstin e draftit të raportit, për të cilin do të diskutohet të enjten në seancën e Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian.

Edhe kësaj radhe përsëritet thirrja për pesë vendet e BE-së për ta njohur Kosovën. "Shprehim keqardhje për faktin se pesë vende anëtare të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe përsëritim thirrjen që ta bëjnë një gjë tillë", thuhet në këtë tekst.

Përmes këtij raporti, Parlamenti Evropian shpreh mbështetjen e plotë për paralajmërimin e Kosovës për të aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

Në të njëjtën kohë u është bashkuar të gjitha qëndrimeve të BE-së në lidhje me agresionin e Ruisë ndaj Ukrainës, ka shpallur sanksione dhe me një rezolutë të veçantë në Kuvend e ka dënuar këtë agresion.

Në tekst kritika Kosovës i janë drejtuar për gjendjen në

gjyqësor. Është shprehur shqetësim për shkak se gjyqësori vazhdon të jetë joefikas dhe i ndjeshëm nga ndërhyrjet politike. Në këtë drejtim është përshëndetur propozimi për reformën e prokurorisë dhe është kërkuar që të merret parasysh mendimi i Komisionit të Venecias.

Parlamenti është në dijeni edhe për planin e qeverisë për vetting të gjykatësve dhe prokurorëve dhe nënvizon se kjo duhet të mbetet vetëm si mundësi e fundit dhe të mos injorohet qëndrimet e BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Është përshëndetur edhe përpjekja për depolitizimin dhe profesionalizimin e shërbyesve civilë.

Nga Qeveria e Kosovës është kërkuar që të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit. "Jemi të shqetësuar se autoritetet ende nuk e kanë zbatuar këtë vendim dhe në këtë mënyrë dëmton përkushtimin e qeverisë për ta forcuar sundimin e ligjit dhe respektin për pavarësinë e gjyqësorit", thuhet në tekst.

Parlamenti, sipas draftit të këtij raporti, shpreh keqardhje për suksesin e kufizuar të nismave për ta përfshirë komunitetin serb të Kosovës në strukturat politike, sociale dhe ekonomike. Ndërkaq, rikujton se

institucionalizimi dhe mësimi i gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe qasja e barabartë në shërbime dhe informacione në gjuhët zyrtare është esenciale.

Duke rikujtuar rolin e medieve si shtyllë të demokracisë, bëhet ftesë për mbrojtje të gazetarëve nga presionet politike dhe thuhet se gjuha fyese ndaj gazetarëve është e papranueshme. Po ashtu, kërkohet që të ketë transparencë më të madhe të medieve, përfshirë edhe të pronësisë së tyre.

Është shprehur keqardhje edhe për vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar votimin e serbëve të Kosovës në zgjedhjet e Serbisë.

Ndërkaq, në tekstin e draftit të raportit për Serbinë shprehet keqardhje për faktin se ky shtet nuk i ka mbështetur sanksionet e BE-së ndaj Ruisë. Në të njëjtin tekst u bëhet thirrje autoriteteve në Serbi që "të dëshmojnë përkushtim të vërtetë ndaj vlerave të BE-së dhe të përshtaten me vendimet dhe qëndrimet e BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë".

Në këtë tekst thuhet se deputetët janë "thelësisht të brengosur" për përhapjen e dezinformatave për agresionin e Ruisë ndaj Ukrainës dhe u kanë bërë thirrje autoriteteve në Serbi dhe Komisionit Evropian që ta

mbështetin infrastrukturën për luftën kundër dezinformatave dhe kërcënimeve të tjera hibride. Parlamentarët evropianë do t'i bëjnë ftesë Serbisë edhe të veprojnë kundër glorifikimit të kriminelëve të luftës dhe ta ndërpresin retorikën nxitëse, e cila keqëson raportet me fqinjët dhe rrezikon stabilitetin rajonal dhe pajtimin. Sikur në tekstin e draftit të raportit për Kosovën ashtu edhe në këtë për Serbinë rikujtohet se përparimi në rrugëtimin drejt BE-së është i lidhur me përparimin në procesin e normalizimit të raporteve me Kosovën.

Nga të dyja palët kërkohet angazhim për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve që do të ishte kyç për përparimin e të dyja palëve në rrugëtimin e tyre evropian.

Për tekstet e këtyre dy drafteve do të diskutohet të enjten, ndërsa pastaj deputetët do të mund të propozojnë edhe amendamente. Më vonë, në formën e Rezolutës së Parlamentit Evropian, do të duhet të miratohen në një seancë plenare. Rezolutat e tilla kanë një rëndësi politike, sepse paraqesin qëndrimet e këtij institucioni të rëndësishëm në BE, por ato nuk kanë fuqi obliguese ndaj vendeve anëtare.



Reçica: Po i rikthejmë bashkatdhetarët në PDK

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Elmi Reçica, ka njoftuar se Departamenti i PDK-së për Çështje të Diasporës po vazhdon angazhimin e vet tashmë si grup i ristrukturuar dhe i riemërtuar si Komisioni për Organizimin e PDK-së në Mërgatë, për ta rikthyer fitoren e madhe bashkë me bashkatdhetarët kudo ku ata jetojnë.

Reçica ka njoftuar se ky ndryshim është bërë me vendimin e fundit në mbledhjes e kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës. “Ky ndryshim ka ndodhur me vendimin e fundit në mbledhjen e kryesisë së PDK-së dhe i jep fokus të veçantë krijimit të strukturave të përhershme të PDK-së në

mërgatë e, si rrjedhim, edhe rikthimit të madh të Partisë Demokratike të Kosovës te të rinjtë, vajzat dhe gratë si dhe te veprimtarët tanë kombëtarë dhe politikë jashtë vendit”, ka thënë ai. Reçica ka thënë se në takimin e parë konstituiv të këtij komisioni është diskutuar për procesin që po zhvillohet me qëllim të përshejtitimit të organizimit të strukturës së PDK-së në mërgatë. “Për këtë qëllim morëm vendim të përbashkët dhe caktuam Këshillin për Organizimin e Kuvendit Zgjedhor të PDK-së për degën e Bavarisë, i cili do të përbëhet nga 15 anëtarë dhe do ta udhëheqë veprimtari dhe humanisti i shquar, biznesmeni i suksesshëm Isak Neziri”, ka thënë Reçica.



Shkatërrohet një laborator droge në Zveçan, arrestohen katër serbë

ZVEÇAN, 20 PRILL (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë një operacioni të zhvilluar ka shkatërruar një laborator droge në komunën e Zveçanit.

Gjatë këtij operacioni janë arrestuar katër persona, një serb, shtetas i Kosovës dhe tre shtetas të Serbisë.

Sipas njoftimit, operacioni është kryer në fshatin Kremestak, pasi policia kishte marrë informacion se në një shtëpi dyshohej se kishte një laborator për kultivimin e kanabisit. Sipas policisë, janë konfiskuar 15 kilo-

gramë substancë e dyshuar marijuanë, e gatshme për treg, bimë të dyshuara të kanabisit, para të gatshme dhe gjësende të tjera. “Vlerësohet se sasia e sekuestruar e marijuanës dhe bimëve të kanabisit e kalon vlerën e shitjes në treg mbi një milion euro, ndërsa pajisjet të cilat janë përdor për mbjelljen, rritjen dhe kultivimin e kanabisit e kalojnë vlerën e mbi 450 000 eurove. Behet fjalë për një grup të strukturuar kriminal i cili ka vepruar në shitjen e narkotikëve në Republikën e Kosovës dhe në

Serbi”, thuhet në njoftim. Autoritetet kanë bërë me dije se të arrestuarit, të cilët kishin tentuar të iknin në momentin që Policia e Kosovës kishte hyrë në shtëpinë ku është gjetur laborator, janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Ndërkaq, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se institucionet e Kosovës do të vazhdojnë që të luftojnë në mënyrë të pakompromis “individë apo grupe, pa dallim dhe kudo në Kosovë, që përmes veprimtarive ilegale cenojnë jetën e qytetarëve tanë”.



Të premtën nis aksioni “Për një Kamenicë të pastër”

KAMENICË, 20 PRILL (ER) - Komisioni i formuar për realizimin e aksionit “Për një Kamenicë të pastër” ka mbajtur të mërkurën një takim, në të cilin është diskutuar për ndarjen e punëve lidhur me aksionin që do të mbahet të premtën për pastrimin e ambientit në komunën e Kamenicës.

Koordinatori i këtij komisioni, Zotrim Kastrati, njëherësh drejtor në Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, ka thënë se ky aksion do të fillojë të premtën nga ora 10:00 deri në orën 12:00 dhe do të vazhdojë edhe në ditët në vazhdim deri më 24 maj. Ndërsa udhëheqësi i Sektorit të

Mbeturinave në DSHPAI, Hysen Jerliu, ka sqaruar në detaje se si do të zhvillohet aksioni. Sipas tij, zhvillimi i këtij aksioni ka për qëllim pastrimin e mjedisit jetësor në territorin e komunës së Kamenicës dhe mbjelljen e drunjve dekorativë, duke shërbyer kjo edhe si fushatë e vetëdijesimit për qytetarët e të gjitha komuniteteve.

Hyseni ka treguar punët dhe detyrat për secilën drejtori dhe sektor, i cili do të ketë rol kyç në këtë ditë.

Lidhur me aksionin “Për një Kamenicë të pastër” ai ka thënë se do të angazhohen zyrtarët komunalë, qytetarët, nxënësit, si



dhe OJQ-të e ndryshme. Ndër të tjera, ai u ka bërë thirrje të gjithë kryetarëve të Këshillave

Lokale t'i përgjigjen këtij aksioni, ndërsa pronarët e lokaleve afariste në qytet dhe vendbanimet rurale

janë të obliguar që para objekteve të tyre ta bëjnë pastrimin e hapësirave.

Nis pastrimi i hapësirave publike rreth lumit në lagjen “Tabakhane” në Prizren

PRIZREN, 20 PRILL (ER) - Ka nisur pastrimi i hapësirave publike rreth lumit në lagjen “Tabakhane” në Prizren. Komuna e Prizrenit ka falënderuar qytetarët aktivë që e kanë ndihmuar komunën t'i identifikojë zonat, lagjet dhe hapësirat të cilat kanë nevojë për intervenime emergjente siç janë: pastrimi i mbeturinave,

pastrimi i deponive, rregullimi i hapësirave publike të dëmtuara, rregullimi i ndriçimit publik aty ku ka prishje, rregullimi i semaforëve jofunksionalë dhe çdo parregullsi tjetër që hasin. “Bëjmë thirrje për secilin qytetar të komunës së Prizrenit, na njoftoni për parregullsitë që mund të hasni. Na shkruani

mesazh, na bëni tag ose na dërgoni fotografi, ne do të përpiqemi të intervenojmë sa më shpejt. Ne mbetemi të përkushtuar për përmbushjen dhe kryerjen e obligimeve dhe punëve tona. Bashkë mund të punojmë më shumë dhe më mirë. Për qytetarët dhe bashkë me qytetarët!”, ka njoftuar komuna e Prizrenit.



“Freedom House” për Kosovën: Institucionet mbesin të dobëta, korrupsioni i shfrenuar

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Në raportin e organizatës “Freedom House” për vendet në tranzicion, i publikuar të mërkurën, Kosova radhitet sërish në grupin e regjimeve hibride/demokraci tranzicionale. Megjithatë aty ka kritika për Kosovën në shumë fusha në pasqyrën e përgjithshme. Korrupsioni, liria e gazetareve dhe sundimi i ligjit radhitet si ndër problemet kyçe të Kosovës.

Në një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 7 pikë, ku 1 është shkalla më e ulët e demokracisë, sipas raportit të sivjetmë, Kosova shënoi një përparim nga 3,14 pikë sa kishte në raportin paraprak, në 3.25.

Rritja është shënuar në kategorinë e qeverisjes demokratike në vend, që ishte 2.50 pikë në raportin e vitit të kaluar, ndërsa këtë vit është 3.00. Vlerësimet për pavarësinë e gjyqësorit janë rritur në 2.75, ndryshe nga 2.50, sa ishte në raportin e kaluar, ndërsa të gjitha vlerësimet e tjera mbeten të pandryshuara nga një vit më parë.

Në raportin për lirinë në botë Kosova ka shënuar ngritje të lehtë në 56 pikë, nga 54 sa ishte në raportin e vitit të shkuar. Në raportin e përgjithshëm ngritje prej dy pikësh ka pasur në platformën e të drejtave politike, ndërsa i njëjtë vlerësimi ka mbetur për liritë civile.

Në përmbledhjen kryesore për Kosovën, “Freedom House” ka theksuar se vendi ka mbajtur zgjedhje kredibile, por ka shtuar se institucionet mbesin të dobëta dhe se korrupsioni i shfrenuar ka shkaktuar mosbesim të thellë publik ndaj qeverisë; se gazetarët përballen me presione serioze dhe rrezikojnë të sulmohen për

raportimet e tyre; dhe se sundimi i ligjit pengohet nga ndërhyrja e ekzekutivit në gjyqësor.

Te zhvillimet kryesore për vitin e shkuar, “Freedom House” ka përmendur fitoren e Vetëvendosjes me mbi 50 për qind në zgjedhjet e përgjithshme të shkurtit. Sa i përket dialogut me Serbinë, është përmendur ngecja që nga korriku i vitit të shkuar kur s’ka pasur më takime në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit serb, Aleksandër Vuçiq. Zgjedhje të drejta dhe të lira i ka cilësuar edhe ato lokale në fund të vitit.

Procesin zgjedhor e ka vlerësuar me 3 pikë nga 4. Dallimi në krahasim me vitin e shkuar ishte ngritja për një pikë sepse, sipas “Freedom House”, zgjedhja e kryeministrit të ri dhe presidentes u bë me procedura normale pas zgjedhjeve të përgjithshme të lira. Njëjtë është vlerësuar edhe zgjedhja e deputetëve. Te çështja e administruesve të zgjedhjeve është përmendur akuza ndaj presidentes Vjosa Osmani se po dështon ta sigurojë pavarësinë e KQZ-së.

Në raport është shkruar edhe për Listën Serbe që është akuzuar se i kërcënon partitë rivale dhe po krijon ambient ku votuesit frikësohen të zgjedhin alternativa të tjera.

Me pikë maksimale është vlerësuar çështja se a ka shanse reale opozita që ta rrisë përkrahjen përmes zgjedhjeve. “Korrupsioni e klientelizmi shpesh bëjnë presion për votë. Biznesmenët e pasur në Kosovë mund të kenë ndikim në zgjedhjet politike të punëtorëve të tyre. Serbia vazhdon të ushtrojë ndikim me platformën e Listës Serbe, si dhe të zgjedhjeve



politike të serbëve etnikë në përgjithësi. Figurat kryesore politike në Kosovë, përfshirë ish-presidentin Hashim Thaçi dhe ish-kryeministrin Ramush Haradinaj, kanë lidhje me krim të organizuar e korrupsion të nivelit të lartë, që kanë rol të madh në politikë dhe ndikojnë në vendosjen e liderëve kyçë”, thuhet në raport për çështjen se “a janë zgjedhjet politike të njerëzve të lira nga forcat dominuese?”. Kjo çështje është vlerësuar me dy nga katër pikët e mundshme. Raporti për këtë çështje është i njëjtë me atë të vitit të shkuar.

Po aq pikë ka marrë edhe çështja e lirisë së komuniteteve të ndryshme, përfshirë atë LGBT, në të drejtat e plota politike dhe mundësitë elektorale.

Te funksionimi i qeverisë, “Freedom House” ka thënë se

sistemi politik i Kosovës në vazhdimësi është karakterizuar me joqëndrueshmëri. “Qeveria Kurti, e zgjedhur në shkurt 2021, kohë pas kohe ka ngecur ta implementojë platformën e orientuar me reforma”, thuhet në raport. Te vlerësimi me 2 prej 4 pikëve, raporti thekson ndikimin e Serbisë në veri të Kosovës, por i kujton edhe ndikimet ruse, kineze e turke në proceset qeverisëse gjatë viteve.

Me vetëm 1 pikë nga 4 të mundshme është vlerësuar pyetja se “a janë të fuqishme dhe efektive masat kundër korrupsionit?” “Korrupsioni dhe shteti i kapur janë të përhapura, dhe korniza institucionale për t’i luftuar është e dobët”, ka thënë raporti që vazhdon se ka vështirësi në organet kryesore kundër korrupsionit t’i koordinojnë përpjekjet e se ka

pak raste kur zyrtarët e lartë ndiqen penalisht.

Te transparencën e qeverisë vlerësimi është bërë me 2 nga 4 pikë. I njëjti vlerësim është bërë edhe te liria e medias, ajo e praktikimit të fesë, e lirisë së sistemit edukativ nga indoktrinimi politik.

Liria e Kuvendit është vlerësuar me 3 nga 4 pikë, aq sa edhe liria e organizatave joqeveritare. “Sa është i pavarur gjyqësori?” është vlerësuar me vetëm një pikë për shkak të “ndërhyrjeve politike që mbesin problem”. Me të njëjtin rezultat ishte vlerësuar edhe në raportin e vitit të shkuar.

Nga vendet e rajonit gjendja është përkeqësuar në Serbi dhe në Bosnjë Hercegovinë, ndërsa në Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Shqipëri situata është e pandryshuar në krahasim me vitin e kaluar.

Goditet grupi kriminal i cili bashkëvepronte në Shqipëri dhe Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 PRILL - Policia e Kosovës, në vazhdim të realizimit të objektivave strategjike në luftën kundër krimit të organizuar dhe të të gjitha llojeve të trafikimit, pas operacionit të djeshëm të realizuar në veri të Mitrovicës, ku ishin arrestuar katër persona dhe ishte shkatërruar një laborator për kultivim të drogës, një operacion të ngjashëm e ka realizuar edhe të mërkurën në orët e hershme të mëngjesit në rajonin e Mitrovicës në jug dhe në Fushë-Kosovë, i cili ka rezultuar me arrestimin e pesë personave të dyshuar dhe konfiskimin e mbi pesëdhjetë e gjashtë (56 kg) substancave narkotike të llojit marijuanë. Operacioni policor është realizuar në bashkëpunim me prokuroritë



kompetente, ku pas hetimeve të zhvilluara janë identifikuar personat e dyshuar të cilët dyshoheshin se në bashkëpunim trafikonin narkotikë, nga Shqipëria në Kosovë, pastaj për destinim jashtë Kosovës. “Si rezultat i hetimeve dhe veprimeve policore fillimisht në lagjen Uglar

të Fushë-Kosovës është identifikuar i dyshuari (transportieri) i parë (S. B.) i cili drejtonte një veturë të tipit ‘Mercedes’, me të cilën transportonte substancën narkotike të fshehur në bunkerin e modifikuar të veturës. Më pastaj përmes Pikës Kufitare Vermicë ka

hyrë edhe i dyshuari i dytë (B. R.) me veturën e tij, po ashtu të tipit ‘Mercedes’, i cili ka vazhduar në drejtim të Mitrovicës Jugu ku e priste personi i tretë (N. M.), me të cilin kanë vazhduar në shtëpinë/garazhin e të dyshuarit e cila gjendej në fshatin Vaganicë”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Bazuar në planet taktike të hetuesve policorë të DHTN-së dhe njësiteve policore, të njëjtët kanë reaguuar duke i arrestuar të dyshuarit në flagrancë, ku gjatë kontrollit të automjetit të dytë dhe të tretit i cili gjendej në garazh, janë zbuluar bunker të modifikuar. “Si vazhdimësi e kontrollit dhe bastisjes së automjeteve (të tria të tipit ‘Mercedes’), dy prej tyre me targa të Shqipërisë, një me targa vendore si dhe bastisjes së shtëpisë, janë arrestuar edhe

personi i katërt dhe i pestë, të dy me inicialet (A. M.)” ka njoftuar Policia e Kosovës.

Në cilësi të provave materiale janë konfiskuar 56 kilogramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, tri vetura të tipit “Mercedes” (dy me targa të Shqipërisë, një me targa vendore, që të tria me bunker të modifikuar në të njëjtën mënyrë), shtatë telefona celularë, 10 507.00 euro si dhe disa monedha lekë të Shqipërisë dhe denarë të Serbisë. Me vendim mbi ndalimin e personave, katër të dyshuarve u është caktuar masa e ndalimit mbi dyshimin e bazuar për përfshirje në veprën penale “Blerja, posedimi shitja e paautorizuar e substancave narkotike psikotropike dhe analoge”, ndërsa i dyshuari i fundit vazhdon në procedurë të rregullt.

Rusinovci: Qeveria ka vonuar ndarjen e subvencioneve për bujqësi

PRISHTINË, 20 PRILL - Ndonëse thirrja për aplikim të bujqve për subvencione është paralajmëruar të bëhet gjatë muajit mars, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, subvencionimi për bujqit për këtë vit do të jetë rreth 50 milionë euro. Sa iu përket vonesave për ndarjen e subvencioneve për bujqit, profesori universitar Imer Rusinovci ka thënë se këto mjete është dashur të ndahen

më herët për shkak se në subvencionim është përfshirë edhe gruri, i cili është mbjellë në vjeshtë. “Konsideroj se është e vonuar thirrja për aplikim, sepse në atë subvencionim është përfshirë edhe gruri i cili është mbjell në vjeshtë. Është dashur të ndodhte në janar, sepse afati optimal agro-teknik i dozës së parë të riplehërimit është fundi i shkurtit. Mendoj se për këtë kulturë strategjike

metodologjitë kanë qenë të vonuara. Qeveria duhet të ketë prioritet edhe shtimin e prodhimit të bujqësore në kuptimin e përpunimit të saj, përkatësisht industrinë agrourbore në mënyrë që importi marramendës të zvogëlohet ose të bjerë në kufijtë normalë për kulturat që mund të bëhen në konditat tona agroekologjike”, ka thënë Rusinovci për “Ekonomia Online”.



Kosova dhe Shqipëria janë duke fuqizuar bashkëpunimin në bujqësi

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 PRILL - Kosova dhe Shqipëria përmes marrëveshjeve të nënshkruara dhe projekteve të përbashkëta bujqësore janë duke e avancuar dhe fuqizuar bashkëpunimin në sektorin e bujqësisë, duke ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik të të dyja vendeve, si dhe duke lehtësuar edhe më tej qarkullimin e prodhimit të bujqësore në mes të dy shteteve, kanë bërë me dije të mërkurën ministri i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci dhe homologa e tij, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë, Frida Krifca, gjatë takimit që kanë mbajtur në Prishtinë. Ministri Peci, pasi ka falënderuar ministren Krifca për vizitën, ka treguar se ky takim është vazhdimësi e bashkëpunimit të aktiviteteve pas marrëveshjes së nënshkruar në mes të dy qeverive

në nëntor të vitit të kaluar. “Tashmë të dy ministrat kemi ndërmarrë hapa konkretë dhe objektivat tona të përbashkëta në sektorin e bujqësisë në mes të dyja vendeve jemi duke i konkretizuar sipas dokumenteve qeveritare të cilat i kemi nënshkruar gjatë vitit të kaluar. Po ashtu, gjatë këtij takimi me homologen Krifca bashkëbiseduam edhe për ide konkrete për projekte të përbashkëta bujqësore, si dhe për ndërmarrjen e masave konkrete për ta vazhduar lehtësimin e rritjes së shkëmbimit tregtar për prodhimet bujqësore dhe eliminimin e barrierave të panevojshme që kanë ekzistuar në të kaluarën”, ka theksuar Peci. Ndërsa ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, ka shprehur gatishmërinë e shtetit të saj për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim të avancimit të politikave të duhura zhvillimore për sektorin e bujqësisë të të dyja vendeve.



BSPK-ja i ofron mundësi qeverisë për dialog



PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Kryesia ekzekutive e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BPSK) ka mbajtur të mërkurën takim me qëllim të shqyrtimit të situatës aktuale dhe të zhvillimeve të fundit pas protestës së 8 prillit, si dhe është paraqitur një raport lidhur me takimin që është mbajtur më 18 prill në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe kryetarit të BSPK-së, Atdhe Hykollit, në të

cilin takim është biseduar për kërkesat tashmë e njohura në protestën e 8 prillit për vazhdimin e pagesës prej 100 eurosh për çdo muaj derisa të fillojë zbatimi i Ligjit të Pagave dhe kërkesave të tjera. BSPK-ja në këtë mbledhje ka vendosur t'i japë përparësi dialogut me qeverinë, duke lënë anash protestat. BSPK-ja vlerëson se kërkesat sindikale mund të arrihen me dialog.

Sipas këtij institucioni, takimi i radhës me kryeministrin Albin Kurti pritet të mbahet së shpejti. “Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës informon anëtarësinë sindikale se kryesia ekzekutive e BSPK-së, pas një diskutimi të gjerë e duke pasur parasysh se ka filluar dialogun me kryeministrin Kurti, dhe deklarimit të tij se kërkesat sindikale do të shqyrtohen me përgjegjësit qeveritarë dhe se

për to do të informohet BSPK-ja për realizimin e kërkesave të paseshura në takimin e radhës, i cili pritet që së shpejti të thirret nga kryeministri, mori vendim që t'i jepet mundësi dialogut duke tentuar që të arrihet marrëveshje me dialog. Pra duke prolonguar veprimet sindikale deri në takimin e ardhshëm të kryesisë ekzekutive të BSPK-së që do të mbahet më 8 prill”, ka njoftuar BPSK-ja.

Ndërpritet seanca për rastin e 53 milionë eurove, Lekaj thotë që s'është pajisur me aktakuzë

PRISHTINË, 20 PRILL - Për shkak se Pal Lekaj ka deklaruar se nuk është pajisur me aktakuzë, është ndërprerë seanca fillestare në rastin e 53 milionë eurove, derisa ai të pajiset me një kopje të aktakuzës. Në këtë rast, Pal Lekaj, ish-ministër i Infrastruktursë, Eset Berisha, këshilltar i lartë politik i tij, si

dhe Nebih Shatri, ish-sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Infrastruktursë (MI) dhe Besim Tahiri, drejtor i Prokurimit Publik në MI, po akuzohen nga PSRK se me rastin e zbatimit të projektit “Autostrada Prishtinë - Han i Elezit R6” kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, me ç'rast buxhetit të

Republikës së Kosovës i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 38 milionë e 321 mijë e 346 eurosh, raporton “Betimi për drejtësi”. Në fillim të seancës së të mërkurës Lekaj ka thënë se nuk është pajisur me aktakuzë, andaj ka propozuar që të shtyhet seanca për dhjetë ditë.



Debati i përjetshëm midis fesë dhe shkencës: A ka një rrugë të tretë?



Nga Andrea MURATORE

A po e kërcënon shkencën shkencizmi? A po harrohet Galileo, dhe a po përdor establishmenti-shkencor dogma të vërteta fetare për çështje që janë aktualisht janë të pavërtetueshme, siç është Teoria e Fijëve? Mbi të gjitha se një pjesë e madhe e establishmentit shkencor, merret me promovimin e bazave shkencore të ateizmit, dhe zhvilluar një luftë kundër Zotit, e cila është e denjë për racionalizmin më të vrazhdë të shekujve XVII–XVIII?

Këto çështje e karakterizojnë shumë debatin e sotëm kulturor. Dhe ato bëjnë të mendosh se dogmatizmi shkencëtar është tek e fundit, i vetmi moment historik mbi të cilin mund të interpretohet realiteti. David Berlinski i vë në pikëpyetje këto çështje në librin e tij “Iluzioni i Djallit”.

Një traktat i thellë filozofik, në të cilin ai tregon sesi dogmatizmi shkencor është promovuar mbi të gjitha, nëpërmjet propagandës së ateizmit militant. Shpesh kjo është realizuar duke rritur mbështetjen për nihilizmin, teksa mendimi fetar dhe shpirtëror shihet si një armik ontologjik i shkencës.

A thua se feja e shkencizmit do të ishte i vetmi kult i vërtetë në vend të fesë, i përjetuar si një akt besimi dhe përkushtimi. Një hebre laik, dhe haptazi agnostik, Berlinski ka njëpërgatitje shkencore dhe filozofike. Ai është diplomuar në

Universitetin Princeton në SHBA, dhe ka kryer kërkime në Universitetin e Kolumbias.

Më vonë ka dhënë filozofi dhe matematikë në universitete të ndryshme (nga Stanford në Sorbonë të Parisit). Mendimtar kozmopolit dhe dinamik, ai e gjen veten të përfshirë në njëpolemikë të hapur me ata që në botën shkencore e mbrojnë ateizmin, dhe që janë të angazhuar në luftën kundër idesë së Zotit, si një parakusht për ushtrimin e drejtë të profesioneve, dhe për të fituar një dukshmëri publike përtej aulave universitare.

Polemika e tij është mbi të gjitha me biologun Richard Doukins, autor i studimeve që përpichen të tregojnë shkencërisht mos-ekzistencën e Zotit. Ajo e Berlinskit nuk është një luftë kundër shkencës. Përkundrazi, është një luftë për shkencën.

Pra për metodën shkencore dhe kërkimin real përtej “hipotezës sipas së cilës, ne nuk jemi gjë tjetër veçse aksidente kozmike”, siç pretendojnë autorë si Doukins, Zhak Monor, Stiven Ueinberg. Berlinski thotë se mendimtarët e mëdhenj të së kaluarës, nga Kenet Miler, një biolog i rëndësishëm darvinian, tek Frensis Kollins, drejtor i projektit “Gjenomi njerëzor”, e pranuan se si ideja fetare u studiua prej tyre në një formë që nuk ishte vetëm militante.

Ndërkaq Stiven Gullid, një ndër studiuesit më të mëdhenj të evolucionit deklaroi se “shkenca dhe feja përbëjnë dy magji, që nuk

mbivendosen dot mbi njëra-tjetrën”. Për të mos përmendur pozicionin e Albert Ajnshtajnit mbi këtë temë, apo dyshimet e mëdha ontologjike që u shfaqën në vazhden e krijimit të bombës së parë bërthamore.

Ideja që një sistem tjetër mendimi mund të përballet me sistemin e tyre, është për Berlinskin problemi i vërtetë që kanë sot shumë shkencëtarë. “Sulmi ndaj mendimit fetar” dhe tallja e botëkuptimit të tij teleologjik dhe transhendent “shënon konsolidimin aktual të shkencës” si i vetmi sistem besimi, “në të cilin burrat dhe gratë racionale mund të gjenin besimin e tyre, në mos besimin, të paktën përkushtimin”.

Nga këtu buron tendenca për të zgjidhur problemet (teoria e përgjithshme, fizika kuantike, studimi i trurit të njeriut) tek të cilat ka ende gjëra për t’u zbuluar. Pra për të zbatuar një metodë të shëndoshë shkencore, të shoqëruar me narrativa.

Edhe vetë teoria e Big Bengut përballet me pasiguri në rritje, ndërsa i afrohet momentit zero të ngjarjes, që do të krijonte kohën dhe hapësirën. Ajo përshkruan me një saktësi të madhe evolucionin e Universit nga një pikë e saktë në kohë dhe hapësirë, dhe sot nuk i jep përgjigje përfundimtare pyetjeve mbi kohën dhe hapësirën.

Dhe vetëm duke nxitur dyshimin, apo studimin sistematik, mund të zbulohet misteri dhe të kuptohet

më shumë. Si një agnostik, Berlinski, na fton të mos tallemi me asnjë hipotezë, madje as atë që qëndron në themelin e të ashtuquajturit “parim antropik” apo idesë së Dizajnit Inteligent.

Ai na fton të ndjekim mësimin e teologut islam El-Gazali, për të cilin është vënë shpesh në pikëpyetje aftësia e “një organi të kufizuar si truri i njeriut për të parë në zemrën e thellë të materies dhe matematikës”. Një opsion edhe më i pamundur, kur i referohemi makinerive dhe algoritmeve që janë në shkallë të ndryshme, një derivat i trurit të njeriut.

Teza bazë e mendimit të Berlinskit, është se duhet të hidhet poshtë çdo narrativëabsolutiste: Si një fe obskurantiste, ashtu edhe një shkencë verbuese, e pengojnë njeriun të shohë me sytë e tij, duke e larguar atë nga kurioziteti, si dhe përdorimi i zgjuarsisë dhe aftësive të tij racionale.

Që të dyja dëshirojnë një kërkim për të vërtetën, e cila kalon përmes supozimit të zotërimit të saj që në fillim. Rëndësia sociale e shkencës në ditët tona, kërkon që ne të hedhim poshtë dogmatizmin e atyre që preferojnë dominimin e paradigmeve dhe narrativave, dhe që e përdorin ateizmin militant si një formë propagande e një feje të re, atë të një shkence monolite dhe aspak të hapur ndaj dyshimeve të komunitetit të saj.


Një shkencë është e tillë, nëse dhe vetëm nëse funksionon sipas një

metode induktive-deduktive, e cila kalon përmes vëzhgimit të dukurive dhe ndërtimit të hipotezave. Ajo nis nga një induksion i domosdoshëm, nëpërmjet vëzhgimeve dhe ndërtimit të formulave, por deduktohet detyrimisht nëpërmjet një eksperimenti.

Kur kjo metodë dështon, krijohet një zhvendosje e rrezikshme fazore, veçanërisht nëse modelimi mbizotëron mbi eksperimentimin real. Por ku është realiteti? Duket sikur ka pasur një divorc me metodën tradicionale të kërkimit. Duket sikur bota ishte një silogjizëm, për të parafrazuar Hegelin: gjithçka që është e arsyeshme është reale, dhe gjithçka që është reale është e arsyeshme.

Nuk ka asnjë dyshim se situata është pak më komplekse, dhe ka të bëjë me dëshirën njerëzore për të zbuluar, eksploruar dhe ditur. Fakte që nuk kanë asnjë mospërputhje me vullnetin për të kërkuar ndjenjën e thellë të ekzistencës, dhe të të kuptuarit e rolit të dikujt në krijimin e Universit.

Pikërisht aty ku mund të bashkëjetojnë shkenca dhe feja. Këtë e dinte edhe Galileo, për të cilin në fund të fundit “matematika, është alfabeti me të cilin Zoti shkroi Universin”. Një vizion i thellë dhe dinamik i mohuar shpesh nga ata që me armën e ateizmit militant, duan të zëvendësojnë shkencën me shkencizmin. / “Il Giornale” – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Peja dhe Ylli kualifikohen në finale

"Epoka e re"

PRISHTINË, 20 PRILL - Në një ndeshje shumë interesante, Peja ka mundur Prizrenin 16 me rezultat 98:94 (23:24, 23:23, 22:28, 30:19), duke u kualifikuar në finale të Ligës Unike, ku do të përballlet me Golden Eagle Yllin. Çereku i parë ishte tërësisht i barabartë, ku të dy skuadrat nuk arrinin të shkëputeshin, ndërsa epërsinë më të lartë e kishin prizrenasit, vetëm katër pikë, 20:24, ndërsa kjo pjesë përfundon 23:24. Edhe periudha e dytë ishte e ngjashme me atë të parën, ku luftohej për çdo top në parket, duke e bërë sfidën tepër interesante dhe luftuese, ndërsa herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, kurse pjesa e parë përfundon 46:47. Në periodën e tretë, basketbollistët prizrenasit ishin më të mirë, duke pasur epërsi disa herë deri në 11 pikë, megjithatë, pejanët në fund nuk dorëzohen, për të ngushtuar shifrat në 68:75, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë interesante dhe dramatike, ku të dy skuadrat e deshën shumë fitoren, megjithatë, më të vëmendshëm ishin verdhezinjtë, që triumfuan në fund 98:94. Te Peja u dalluan Courtney Fells me 31 pikë dhe Dardan Berisha me 24, ndërsa te Prizreni 16 u dalluan Darell Davis me 20 pikë e 14 kërcime, Xavier Cannefax me 20 pikë dhe Altin Morina me 17 pikë. Ndërsa Golden Eagle Ylli është kualifikuar në finale të Ligës Unike, duke mundur Teutën në gjysmëfinale me rezultat të ngushtë 84:82 (21:15, 15:23, 22:18, 26:26), ku fituesi u



vendos në sekondat e fundit me pikët nga Erjon Kastrati. Therandasit e nisën ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi konstante në çerekun e parë, ku më e larta ishte 21:14, ndërsa kjo pjesë përfundoi 21:15. Por, periudha e dytë 'foli' në të mirë të durrsakëve, që shkrin epërsinë dhe e kthyen atë në favor të tyre, 31:38, megjithatë pesë pikë radhazi nga kampionët bënë që skuadrat të shkojnë në pushim me rezultat 36:38. Perioda e tretë ishte interesante, me skuadrën nga Durrësi që kishte epërsi deri në pesë pikë dhe therandasit deri në shtatë pikë, duke e bërë sfidën shumë interesante, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 58:56. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë shumë interesante, ku fituesi është vendosur në sekondat e fundit

dhe të dy skuadrat e kishin mundësinë për të fituar, megjithatë, ai që vendosi ishte Erjon Kastrati në sekondat e fundit për 84:82 dhe kualifikoi kampionët në finale.

Te Golden Eagle Ylli u dalluan Mikaile Tmusiq me 23 pikë, pesë pikë, gjashtë asistime, Henrik Sirko me 17 pikë, dhjetë kërcime e shtatë asistime dhe Erjon Kastrati me 22 pikë e katër asistime, kurse te Teuta u dalluan Nasir Core me 23 pikë, Fabien Lilaj dhe Tyler Peterson me nga 13 pikë.

ORARI

Golden Eagle Ylli - Teuta 84:82
Peja - Prizreni 16 98:94

Të enjten takohen:
17:00 Teuta-Prizreni 16
20:30 Golden Eagle Ylli-Peja

SHKURT

Kosova U17 mposhtet nga Ukraina

Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll ka pësuar humbje 2-0 nga Ukraina në ndeshjen e vlefshme për kualifikimet në Kampionat Evropian 2022. "Dardanët" pësuan dy herë gjatë pjesës së dytë. Ishte fillimisht Kremchanin që shënoi për avantazhin e ukrainasve në minutën e 75-të, për ta vulosur më pas fitoren me golin e Gusievit në minutën e 90. Kjo ishte njëkohësisht ndeshja e parë në grupin 6 për djemtë e Arsim Abazit. Pos Ukrainës, në grup me Kosovën gjenden edhe Polonia e Italia. Ndeshja e radhës e "dardanëve" do të jetë ajo kundër Italisë më 23 prill, ndërsa tri ditë më vonë do t'i matë forcat kundër Polonisë.

Tare e dëshiron Bajramin te Lazio


Nedim Bajrami është lojtari i radhës që Igli Tare e dëshiron te Lazio. Futbollisti shqiptar i Empolit korrespondon me idetë e lojës së Maurizio Sarrit dhe vizionin e tij për mesfushën. Bajrami është një lojtar teknik që mund të luajë gjithashtu një rol më të avancuar. Në këtë kampionat ai ka shënuar 6 gola dhe asistuar 5 herë për skuadrën toscane. Megjithatë, Lazio do të duhet t'u kushtojë vëmendje operacioneve të tregut të transferimeve të Sassuolos që, gjithashtu, synon Bajramin. Empoli e vlerëson jo më pak se 10 milionë euro mesfushorin shqiptar. Kohë më parë interesim për Bajramin kishte treguar edhe skuadra e Milanit.

Pritet përjashtimi i tenistëve rusë dhe bjellorusë nga Wimbledon

Nuk ka Wimbledon për tenistët rusë dhe bjellorusë. Sipas "New York Times", organizatorët e turneut duhet ta shpallin vendimin në orët në vijim. Një përjashtim i lidhur padyshim me luftën në Ukrainë dhe i cili u konfirmua nga një "ekzekutiv i rëndësishëm ndërkombëtar tenisi" i cili dëshironte të mbetej anonim "sepse ai nuk ishte i autorizuar të fliste në emër të Klubit All England". Nëse po, Wimbledon, i cili fillon më 27 qershor në Londër, do të përjashtojë numrin 2 të botës Daniil Medvedev dhe numrin 8 Andrey Rublev nga turneu. Në fushën e femrave, tre teniste ruse dhe bjelloruse ndër 20 më të mirat e renditjes WTA: Aryna Sabalenka (4), Anastasia Pavlyuchenkova (15) dhe Victoria Azarenka (18).

Muriqi: Pirati është këtu dhe do të luftojmë deri në fund

MALLROCA, 20 PRILL - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka qenë edhe një herë protagonist te Mallorca, duke kontribuar në fitoren e ekipit të tij ndaj Deportivo Alavesit (2-1). Muriqi e realizoi golin e dytë për skuadrën e tij në fund të pjesës së parë. "Pirati është këtu dhe do të luftojmë deri në fund", ka shkruar 27-vjeçari në rrjetin social



"Instagram". Sulmuesi prizrenas e shënoi golin e katërt në La Liga këtë sezon, derisa është i huazuar në Mallorca për gjashtë muaj dhe klubi spanjoll ka vendosur të mos e blejë kartonin e tij përkundër formës së mirë në të cilën po kalon në ndeshjet e fundit. Kartonin e tij e ka në pronësi Lazio, e cila do të përpiqet ta shesë lojtarin gjatë verës që vjen.

Fury konfirmon tërheqjen: Ky do të jetë fundi i karrierës time

Kampioni i botës në peshën e rëndë, boksieri britanik Tyson Fury, ka insistuar në deklaratën e tij se pas sfidës që do të zhvillojë këtë të shtunë ndaj Dillian Whyte, do të tërhiqet nga sporti. Ai shprehet se pas kaq shumë vitesh në ring është koha të ndalet, si i

pamposhtur dhe kampion bote. 33-vjeçari britanik e konfirmoi edhe më herët këtë tërheqje, por njerëzit nuk e besuan. Ndaj ai iu rikthye kësaj teme në prag të sfidës që do të zhvillojë para fansave të tij, në stadiumin "Wembley" të Londrës, ku do ta mbrojë titullin e

kategorisë WBC. "Këtë javë do ta shijoj në maksimum. Ky do të jetë fundi për mua. Do të marr një fitore të mirë të shtunën dhe më pas relaks. Do të ulem në karrige dhe do ta shijoj jetën time", ka thënë Tyson Fury, 31 fitore e 1 barazim në karrierë. "Ka qenë një

udhëtim i gjatë, me ulje e ngritje në karrierën time. Kam gati 20 vjet karrierë, jam gati 34 vjeç dhe mendoj se kjo është e mjaftueshme për këdo. Ka shumë gjëra që do të bëj me fëmijët e mi, më pas do ta shijoj jetën", është shprehur Fury.



Gjinovci: Synojmë kualifikimin në Evropian

PRISHTINË, 20 PRILL - Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Izet Gjinovci, ka dhënë një intervistë të gjatë për portalin e njohur nga Bosnjë Hercegovina "Sportsport.ba". Gjinovci ka folur për tema të shumta, duke përfshirë sukseset e hendbollit kosovar, por edhe sfidat. Kosova dhe Bosnjë Hercegovina janë në një grup në kualifikimet për "Euro 2024", ndërsa Gjinovci ka folur edhe për këtë temë. "Shorti i kualifikimeve për Evropian ka formuar një grup shumë interesant. Jemi në një grup me ekipe nga ish-Jugosllavia. Ndonëse grupi duket shumë i vështirë, ne jemi të lumtur, pasi do të takohemi me ekipe që i njohim mirë, sidomos Malin e Zi, por edhe Slloveninë që është në rënie marrë për bazë rezultatet e fundit. Kjo na jep më shumë shpresa për rezultat më të mirë, të paktën në Prishtinë", ka thënë Gjinovci. "Lojën e Malit të Zi e njohim shumë mirë, duke marrë parasysh që vitin e kaluar e humbëm



ndeshjen vendimtare për kualifikim në Evropianin 2022, kështu që shpresojmë në revansh. Por që të kualifikohemi në Evropian na duhet fitorja apo rezultat më i mirë në dy ndeshje me Bosnjë Hercegovinën. Ne shpresojmë se do të kemi përparësi duke marrë për bazë që ekipi ynë është në ngritje, ndërsa

Bosnja po e bën ndryshimin e gjeneratës që ne duhet ta shfrytëzojmë. Për ne është hera e tretë që paraqitemi në kualifikime për Kampionat Evropian dhe vazhdimisht kemi pasur përparim. Është reale të presim që herën e tretë do ta sigurojmë kualifikimin në Evropian", ka deklaruar Gjinovci.

New Orleansi befason Phoenixin, 'fluturon' Miami

PHOENIX, 20 PRILL - Surpriza në ndeshjet çerekfinale të "play-off"-it në NBA. Ekipi i Phoenixit, që regjistroi rekordin më të mirë gjatë sezonit të rregullt, u mund me rezultat 125-114 në fushën e tij nga New Orleansi. Ingram me 37 pikë e McCollum me 23 befaskan vendasit, për të cilët Booker realizoi 31 pikë, por që s'mjaftuan për ta



shmangur humbjen. Barazim 1-1 me ndeshje me Memphisit e Minnesotas, me vendasit që fituan me rezultat 124-96, në një sfidë të komanduar totalisht. Vendimtar për Memphisin lojtarët e stolit, që realizuan plot 70 pikë, duke bërë diferencën në fushë. Në Lindje ekipi

i Miamit udhëheq 2-0 serinë, pas fitores me rezultat 115-105 arritur ndaj Atlantës. Bogdanoviçi me 29 pikë e Youngu me 25 u përpoq të mbajnë në lojë miqtë, por pa sukses. Për Miamin shkëlqeu Jimmy Butler, autor i 45 pikëve, lider në fushë.

Konferenca e Lindjes - Çerekfinale "play-off"

Miami - Atlanta	115-105 (2-0)
Philadelphia - Toronto	(2-0)
Milwaukee - Chicago	(1-0)
Boston - Brooklyn	(1-0)

Konferenca e Perëndimit - Çerekfinale "play-off"

Phoenix - New Orleans	114-125 (1-1)
Dallas - Utah Jazz	(1-1)
Golden State - Denver	(2-0)
Memphis - Minnesota	124-96 (1-1)


Pogba arrin marrëveshje me PSG-në

Nuk do të jetë Juventus destinacioni i radhës për Paul Pogban. Mesfushori francez duket se ka nënshkruar një parakontratë me Paris Saint

Germainin. Sipas medieve në Francë, kampioni i botës do të nënshkruajë një kontratë katër-vjeçare me klubin "Park De Princ" në fund të sezonit.

Mesfushori pritet të largohet nga Manchester Unitedi si lojtar i lirë në merkaton e verës pasi kontrata e tij me "Djajtë e Kuq" skadon më 30 qershor të këtij viti. Për 29-

vjeçarin kanë shfaqur interes edhe klube të tjera si Real Madridi apo Juventus, por në Francë besojnë se mesfushori ka zgjedhur ekipin parisien për ta vijuar karrierën.



SHKURT

Pioli: Tash përqendrohemi në kampionat

AC Milan u eliminua nga Kupa e Italisë, pasi pësoi humbje nga Interi (3-0). Trajneri i kuqezinjve, Stefano Pioli, e pranoi humbjen, por nuk e fsheh keqardhjen për golin e anuluar të Bennacerit që mund ta rihapte ndeshjen. Trajneri i Milanit ka kërkuar nga futbollistët që tash të përqendrohen në kampionat. "Interi u tregua më i zoti se ne dhe shfrytëzoi mjaft mirë rastet e krijuara. Humbja është e pastër, por ne golin tonë e bëmë. Portieri nuk protestoi për asnjë moment për pozicion jashtë loje dhe ky është një rast i çuditshëm. Kundërshtarët protestuan për prekje me dorë, por goli u anulua për pozicion jashtë loje. Nuk është momenti që të qajmë këtë humbje, pasi kemi fazën finale të kampionatit dhe duhet të reagojmë në mënyrën e duhur. I njoh mirë djemtë dhe e di që do të reagojnë që në ndeshjen e radhës ndaj Lazios", ka thënë Pioli.

Pele shtrihet sërish në spital

Pele u shtrua në spital, por ai është në gjendje të stabilizuar dhe do të dalë nga spitali në ditët në vijim. Përmes një deklaratë, spitali "Israelita Albert Einstein" bëri me dije se pranimi i "O'Rei" do të vazhdonte me trajtimin e një tumori të zorrës së trashë. "Edson Arantes do Nascimento u shtrua në spitalin Israelita Albert Einstein për ta vazhduar trajtimin për një tumor të zorrës së trashë, të identifikuar në shtator 2021", thuhet në deklaratë. "Pele, i konsideruar si një nga lojtarët më të mëdhenj të futbollit në histori, është në gjendje të mirë dhe së shpejti do të lirohet nga sanatoriumi", shton dokumenti. "Gjendja e tij klinike është e mirë dhe stabile, dhe daljen nga spitali duhet të ndodhë në ditët në vijim", përfundon deklarata e shkurtër. Kampioni i botës tri herë me Brazilin iu hoq tumori i zorrës së trashë në shtator të vitit të kaluar dhe që nga ajo kohë ai ka bërë vizita të rregullta në spital për ta vazhduar trajtimin.

Nëse dështon Haalandi, Reali transferon Cavanin

Real Madridi varet nga Erling Haalandi. Klubi "Loss Blancos" po i merr parasysh të gjitha hipotezat dhe dëshiron që mos të jetë i papërgatitur në verë. Në rast se dështon transferimi i Erling Haalandit, gjiganti i La Ligës e ka një zgjidhje. Plani B quhet Edinson Cavani, sipas "Fichajes". Sulmuesi uruguaijan është në fund të kontratës me Manchester Unitedin dhe kalimi tek ekipi i Carlo Ancelottit do t'i sillte grupit më shumë përvojë dhe cilësi. Profili i tij me këtë skuadër do të ishte tejet interesant dhe, mbase, i nevojshëm për skemat e teknikut italian. Për Cavanin do të ishte përvoja e tij e parë në La Liga, pas viteve të suksesshme me Palermon, Napolin dhe PSG-në.



Shoqata Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Nëna Tereza"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"
10000 Prishtinë, R. ULPIANA 1111 | p.n. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.mtereza.org e-mail: mtereza@yahoo.com

NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS FURNIZIM

Sipas Nenit 41 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 19/04/2022

Nr i Prokurimit	Ukraina	001	2022	121
-----------------	---------	-----	------	-----

Ky njoftim është përgatitur në Gjuhët:

Shqip Serbisht Anglisht

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Shoqata Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Nëna Tereza"		
Adresa Postare: Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1		
Qyteti Prishtinë	Kodi postar: 10000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Zef Shala		Telefoni: 044128277
Email: zefshala@hotmail.com		Faksi: 038542869
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Jo

Nëse po, specifikoj identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoj një Aneksi.

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me artikuj Ushqimor dhe Joushqimor Made in Kosova (Prodhime Vendore)

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Furnizime	
<input type="checkbox"/> Blerja	
Vendi kryesor i dorëzimit Sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues	

II.1.3) Njoftimi përfshinë, nëse aplikohet

Përmbylljen e kontratës publike kornizë me një operator

Përmbylljen e kontratës publike kornizë me disa operatorë

Kohëzgjatja e marrëveshjes kornizë: në muaj

II.1.4) Përshkrimi i shkurtër i lëndës së kontratës

Furnizim me artikuj Ushqimor dhe Joushqimor Prodhim Vendor Made in Kosova dedikuar popullatës së qendrosur nga Ukraina

II.1.5) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP)

15.00.00.00-8

II.1.6) Ndarja në Pjesë

Po

II.1.7) Vlera e parashikuar e kontratës: rreth 76,000.00 Euro

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

E hapur

III.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

III.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Njoftimi për kontratë 08.04.2022

SECTION IV: DHËNIA E KONTRATËS

(Në rast të disa pjesëve të dhëna disa operatorëve ekonomik të suksesshëm, përsërit S IV.4 dhe IV.5 për secilën pjesë)

IV.1) Data e dhënies së kontratës	19/04/2022	
IV.2) Data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës	22/04/2022	
IV.3) Numri i tenderëve të pranuar		
IV.4) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata		
Emri zyrtar	Lloti nr.1 M-Silloi	14,400.00 Euro
	Lloti nr.2 Ventius International	19,975.00 Euro
	Lloti nr.3 E-BAA	39,496.96 Euro

IV.5) Informacione mbi vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme e kontratës 68,871.96 Euro

IV.6) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktohet Jo

SECTION V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për dhënie të kontratës.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shto informacione tjera:

Shtojce: Kopja e deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve

NJOFTIMIN PËR SHPËRBËRJEN VULLNETARE

Kuvendi i Aksionarëve i shoqërisë tregtare Positive House Sh.P.K. (me numër unik identifikues 811294587, me seli në Prishtinë, ka vendosur që të përmbyll veprimtarinë e saj ekonomike në Kosovë me shpërbërje vullnetare të kësaj shoqërie tregtare. Kreditorët eventual të shoqërisë tregtare Positive House Sh.P.K. apo palët tjera të interesuara mund t'i paraqesin kërkesat dhe ankesat e tyre brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi në adresën e poshtëshënuar:
Rr. Ndue Përlleshi 13, Prishtinë, 10000, Kosovë

NOTICE ON VOLUNTARY DISSOLUTION

Shareholders Assembly of business organization Positive House L.L.C with unique identification number 811294587, has decided to close its economic activity in Kosovo by voluntary dissolution of this business organization. Potential creditors of business organization Positive House L.L.C or other interested parties may submit their claims and complaints within 30 days from the date of promulgation of this Notice to the following address:
Ndue Përlleshi 13, Prishtina, 10000, Kosovë

OBAVEŠTENJE O DOBROVOLJNOM ZATVRANJU

Skupština akcionara privrednog društva Positive House d.o.o. sa jedinstvenim identifikacionim brojem 811294587, je odlučila da zatvori svoju privrednu delatnost na Kosovu dobrovoljnim gašenjem ove poslovne organizacije. Potencijalni poverioci privrednog društva Positive House d.o.o. ili druga zainteresovana lica mogu podneti svoje zahteve i prigovore u roku od 30 dana od dana objavljivanja ovog obaveštenje na sledeću adresu:

Ndue Përlleshi 13, Prishtina, 10000, Kosovë

Data/Date/Datum 21.04.2022, Vendi/Place/Mesto:

Prishtinë/Prishtina/Prishtina,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 2077/1
Datë: 20.04.2022

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPAR), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjensioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjensioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjensioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjensioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Durrës (prej 04 deri 08 Maj 2022).
- Agjensioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës.
- Agjensioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjensioni duhet të posedojë referencat nga organizimet e llojit të njëjtë në të kaluarën.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt. 04.05.2022 dhe kthimi më dt. 08.05.2022.
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.
- Në të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.
- Hoteli të posedojë sallë për ballo
- Agjensioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturore historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).
- Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër, Berat, Vlorë, Shkodër.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve dhe numri
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarf (në zarfin e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfin e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyrat e AAAPAR në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p. n. nderta MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërroj varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në shkollë, pasdite në të njëjtën ditë.]

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



Shkolla e Mesme e Profesionale

“Ymer Prizreni” Prizren

Kosovë 20000 Prizren rr. Bajram Curri pn

Nr. tel. 038/20035377

e-mail: mgavazaj@hotmail.com

facebook: shmel "Ymer Prizreni"



FTESË PËR OFERTË

Për ekskursionin e maturantëve të SHMLP “Ymer Prizreni” në Prizren në Republikën e Shqipërisë.

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Kompanitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të SHMLP “Ymer Prizreni” në Prizren për në Republikën e Shqipërisë, më datën 11.05.2022 deri me 15.05.2022

Pjesëmarrësit e interesuar në tender për dokumentacionin dhe kushtet e kërkuara nga ana e shkollës i kanë të paraqitura në aplikacion.

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuar me dokumentacionin të dorëzohen në DKA në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë kalendrike, nga dita e publikimit në gazetë.

Të interesuarit aplikacionet mund t'i tërheqin në lokalet e shkollës prej orës 8:00 deri në orën 15:00 dhe atë gjatë ditëve të punës.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve nuk mund të bëhet ditën e shtunë dhe të diel, për shkak se këto dy ditë nuk punon administrata e shkollës.

Shkolla mban të drejtën për anulimin e ofertës.



Republika e Kosovës



Gjimnazi "Remzi Ademaj"



Komuna e Prizrenit

Nr. 1142
Datë: 20.04.2022

Mbështetur në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ Aktivitete jashtëshkollore – Ekskursionet shkollore nr. 2/2016 të datës 12.01.2016, në bazë të Vendimit të KDSH, të datës 19.04.2020 nr. 1141, Këshilli Drejtues i shkollës “Remzi Ademaj” në Prizren bënë këtë:

FTESË PËR OFERTË

Për ekskursionin e maturantëve të Gjimnazit “Remzi Ademaj” në Prizren në Republikën e Shqipërisë.

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Kompanitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të SHML “Remzi Ademaj” në Prizren për në Republikën e Shqipërisë, më datën 16.05.2022 deri me 20.05.2022.

Kompanit e interesuara duhet ti plotësojnë dokumentacionet e kërkuara sipas UA 2/2016 shtojca 2.

Pjesëmarrësit e interesuar për ofertë për dokumentacionin dhe kushtet e kërkuara nga ana e shkollës i kanë të paraqitura në aplikacion.

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuar me dokumentacionin të dorëzohen në DKA në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë kalendrike, nga dita e publikimit në gazetë.

Të interesuarit aplikacionet mund t'i tërheqin në lokalet e shkollës prej orës 8:00 deri në orën 15:00 dhe atë gjatë ditëve të punës.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve nuk mund të bëhet ditën e shtunë dhe të diel, për shkak se këto dy ditë nuk punon administrata e shkollës.

Shkolla mban të drejtën për anulimin e ofertës.



UD Drejtori:
Islam Bajrami



Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitës të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh.A. Prishtinë, shpallë:

K O N K U R S E T

Për pozitat:

I. Teknik/e i/e IT-së, një (1)

Departamenti i Administratës, Sektori i IT, nr. i referencës: 04/6

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Instalimi, konfigurimi, mirëmbajtja e rrjetit dhe pajisjeve të IT-së (PC, Printer, Fotokopje, etj.);
- Zhvillimi i Softuerit, po ashtu mirëmbajtja e Ueb Sajtit;
- Bën zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të reja që mund të zhvillohen brenda IT-së për nevojat e ndërmarrjes;
- Ndihmon punëtorët e ndërmarrjes në raste të përdorimit të pajisjeve dhe programeve të IT-së;
- Ndihmon në futjen e shënimeve në sisteme të ndryshme si ueb sajt dhe sisteme tjera;
- Intervenon sipas kërkesave të zyrtarëve në të gjitha rastet për evitimin e prishjeve teknike në aparaturën kompjuterike.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi universitar;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office).

Procedura e Konkurrimit:

Kandidati-ja për pozitën **Teknik/e i/e IT-së** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e letënjohimit dhe ekstraktin e lindjes;
- Letër motivimin.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi për tre (3) vite tjera në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

II. Dispeçer/e (Menaxher/e i/e Kontrollit të vendparkingjeve), tre (3)

Departamenti i Operimeve, Sektori i Kontrollit të vendparkingjeve, nr. i referencës: 05/3

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyrja dhe puna me personelin i cili punon në teren;
- Evidentimi i punës jo të rregullt në teren, evidentimi i punës jo të rregullt të sistemit dhe mënjanimi i gabimeve;
- Mirëmbajtja e kompjuterëve portativ (verifikimi i korrektesisë së punës të kompjuterëve portativ dhe pajisjeve tjera);
- Përgatitja e kompjuterëve portativ dhe pajisjeve përcjellëse për punë në terren (mbushja e baterive, rregullimi i parametrave të pajisjeve dhe printerëve);
- Dhënia e pajisjeve për punën e kontrollorëve (kompjuterin portativ PocketPC dhe printerin portativ) në fillim të ndërrimit dhe pranimit në fund të ndërrimit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi universitar;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Preferohet të ketë patentë shofer, kategoria B.

Procedura e Konkurrimit:

Kandidati-ja për pozitën **Dispeçer/e (Menaxher/e i/e Kontrollit të vendparkingjeve)** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e letënjohimit dhe ekstraktin e lindjes;
- Letër motivimin.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi për tre (3) vite tjera në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

III. Kontrollor/e, njëzet e dy (22)

Departamenti i Operimeve, Sektori i Kontrollit të vendparkingjeve, nr. i referencës: 05/3

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollimi i korrektesisë së parkimit në parkingjet rrugore dhe lëshimi i dënimeve kontraktuale;
- Marrja e kompjuterit portativ nga dispeçeri në fillim të ndërrimit dhe lajmërimi për punë në të;
- Vizita në vendet e përcaktuara;
- Evidentimi i veturave, përkatësisht shfrytëzuesve të parkingjeve të cilët kanë bërë shkelje të dispozitave të rregulloreve të Ndërmarrjes për organizimin dhe mënyrën e pagesës së parkimit;
- Regjistrimi i të dhënave të automjetit dhe lokacionin e shkeljes në kompjuterin portativ;
